

## **UDHËZIM**

**“ Mbi Procedurat e Dështimit në Shlyerjen e Transaksioneve të Titujve të Borxhit të Qeverisë në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE”**

Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 22.11.2018  
Ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.51, datë 18.03.2022

## TABELA PËRMBLEDHËSE

1.	OBJEKTI .....	3
2.	QËLLIMI .....	3
3.	BAZA LIGJORE.....	3
4.	PËRKUFIZIME .....	3
5.	TË PËRGJITHSHME .....	5
5.1	Dështimi i Transaksioneve .....	5
5.2	Përgjegjësia përpara Bursës ALSE për shlyerjen e transaksioneve .....	5
5.3	Detyrimet e Anëtarëve për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në Bursën ALSE.....	5
5.4	Koha e Shlyerjes së Transaksioneve.....	5
5.5	Koha e Shlyerjes Finale të Transaksioneve.....	5
6.	PROCEDURAT NË RAST TË DËSHTIMIT NË VLERA MONETARE (CASH) .....	6
6.1	Dështimi në Vlera Monetare nga Anëtarët që janë Agjentë Shlyerës (ASH).....	6
6.2	Dështimi në Vlera Monetare nga Anëtarët që janë Agjentë Jo-Shlyerës (AJSH).....	6
7.	PROCEDURAT NË RAST TË DËSHTIMIT NË TITUJ .....	7
7.1	Dështimi në Tituj nga Anëtarët që janë Agjentë Shlyerës (ASH).....	7
7.2	Dështimi në Tituj nga Anëtarët që janë Agjentë Jo-Shlyerës .....	8
8.	PROCEDURAT E NDJEKURA NË PERIUdhËN E PAS-DËSHTIMIT (POST-DEFAULT) .....	9
8.1	Procedurat e Pas-Dështimit në Vlera Monetare (cash) .....	9
8.2	Procedurat e Pas-Dështimit në Tituj .....	9

## 1. OBJEKTI

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave që ndiqen nga Bursa ALSE, kujdestarët e titujve, firmat e brokerimit si dhe palët e tjera në lidhje me rastin e dështimit (default) të realizimit korrekt të procedurave të klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve në vlera monetare (cash) dhe në tituj.

## 2. QËLLIMI

Rregullimi i procesit të dështimit të transaksioneve të ekzekutuara në Bursën ALSE në titujte Qeverisë, si dhe të drejtat e detyrimit e palëve në proces.

## 3. BAZA LIGJORE

Hartimi i këtij udhëzimi bazohet në:

- a) Ligji nr. 62/2020, datë 14.05.2020, "Për Tregjet e Kapitalit",
- b) Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE
- c) Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 21, datë 26.03.2009 "Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë",
- d) Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 22, datë 26.03.2009 "Për tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë së RSH-së"(e ndryshuar),
- e) Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 115, datë 11.09.2008 "Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive dhe të librit të transaksioneve"
- f) Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 124, datë 7.12.2010 "Mbi afatet, kushtet dhe procedurat për autorizim të bankave si kujdestarë të obligacioneve" (e ndryshuar),
- g) Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 165, datë 23.12.2008 "Për licensimin e Shoqërive të Brokerimit/Këshillimit, Brokerit Fizik/Këshilltarit të investimeve" (e ndryshuar),
- h) Rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)" (e ndryshuar),

## 4. PËRKUFIZIME

**"AFISaR"**: është *sistemi* qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve shtetërorë në Shqipëri (Albanian Financial Instrument Settlement and Registration) , i cili administrohet nga Banka e Shqipërisë,

**"Titujt e Qeverisë"**: janë tituj borxhi afatshkurtër dhe/ose afatgjatë (Bono dhe/ose Obligacione Thesari) që emetohen nga Ministria e Financave,

**"Agjenti Shlyerës - ASH"**: nënkupton çdo institucion financiar që ka llogari shlyerje në sistemin e pagesave AIPS të Bankës së Shqipërisë, të licensuar nga AMF si Kujdestar Titujsh, i cili është Anëtar i Bursës ALSE dhe është kontraktuar nga Shoqëria Komisionere, për shlyerjen e transaksioneve në përputhje me dispozitat ligjore e rregullative në fuqi,

**"Agjenti Jo-Shlyerës - AJSH"**: Një Anëtar i ALSE, i cili ka nënshkruar një marrëveshje me një *Agjent Shlyerës* Anëtar të ALSE, që siguron shlyerje në mënyrë indirekte për transaksionet e ekzekutuara në ALSE për llogari të Anëtarit përkatës në ALSE,

**"AIPS"**: është sistemi ndërbankar i pagesave me vlerë të madhe në Shqipëri (Albanian Interbank Payment System), i cili administrohet nga Banka e Shqipërisë,

**“AMF”**: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**“Kujdestar i Titujve”**: është ndërmjetësi financiar i cili ofron shërbime ndihmëse të titujve sipas specifikimeve të përcaktuara në Ligjin “Për Tregjet e Kapitalit” dhe në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë për AFISaR,

**“Anëtar”**: nënkupton çdo Bankë dhe Shoqëri Komisionere të licensuar nga AMF, për të ushtruar aktivitetin e tregtimit të titujve dhe të autorizuar nga Bursa për të kryer transaksione me tituj në platformën elektronike të Bursës,

**“Bursa ALSE”**: Bursa Shqiptare e Titujve ALSE sh.a.

**“Dështimi në Vlera Monetare (Cash Default)”**: nënkupton kryerjen e një transaksioni blerje titujsh mes dy palëve, ku palës blerëse i mungon plotësisht ose pjesërisht vlera e nevojshme monetare për shlyerjen përfundimtare të këtij transaksioni,

**“Dështimi në Tituj (Securities Default)”**: nënkupton kryerjen e një transaksioni blerje titujsh mes dy palëve, ku palës shitëse i mungon plotësisht ose pjesërisht sasia e nevojshme e titujve për shlyerjen përfundimtare të këtij transaksioni,

**“Transferim pa Pagesë (FoP)”**: janë transfertat të titujve, të cilat nuk shoqërohen me transfertat të vlerave monetare,

**“OTC (over-the-counter)”**: nënkupton tregun e decentralizuar të Titujve të Qeverisë që kryhet mes bankave (tregu ndërbankar) dhe/ose tregun mes bankave dhe personave fizikë/juridikë në sportelet e bankave (tregu me pakicë). Njihen ndryshe edhe si transaksione “*Jashtë Burse*” (Off-Exchange),

**“Pozicion”**: nënkupton gjendjen e balancës aktuale të një llogarie në vlera monetare (cash) ose tituj,

**“Shlyerja”**: është procesi i kompletimit/përfundimit të transaksionit të tregtimit, ku pala shitëse transferon titullin te pala blerëse dhe kjo e fundit transferon vlerën monetare tek pala shitëse, sipas afateve të përcaktuara nga Bursa ALSE,

**“Shlyerja Finale”**: është një shlyerje që është e parevokueshme dhe e pakushtëzuar, sipas afateve të përcaktuara nga Bursa ALSE,

**“Transaksion i Dështuar”**: nënkupton dështimin e palëve në transaksion për të përmbushur me sukses brenda afateve kohore të dakordësuara më parë, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të detyrimeve në vlerë monetare apo tituj që rrjedhin nga transaksioni,

**“T+n”**: nënkupton një numër prej “n” ditësh pune që vijnë pas ditës së tregtimit të titujve (T+0),

**“Sistemi Elektronik i Tregtimit (ETS)”**: është platforma elektronike e tregtimit që kryen tregtimin (përputhjen e urdhrave) e të gjithë Titujve të kuotuar në ALSE,

## 5. TË PËRGJITHSHME

### 5.1 Dështimi i Transaksioneve

Një transaksion konsiderohet i dështuar nëse palët në transaksion nuk arrijnë të përmbushin me sukses brenda afatit kohor të përcaktuar në rregulloret dhe udhëzimet e Bursës ALSE shlyerjen e plotë të detyrimeve në vlerë monetare apo tituj që rrjedhin nga transaksioni.

Transaksioni i dështuar mund të jetë në dy forma:

- a) **Dështim në Vlerat Monetare (Cash Default)** –Ky dështim shkaktohet nga pala blerëse në transaksion.
- b) **Dështim në Tituj (Securities Default)** – Ky dështim shkaktohet nga pala shitëse në transaksion.

Pas dështimit të transaksionit, Bursa ALSE merr masa për Shlyerjen Finale siç parashikohet në Seksionin 8-të këtij udhëzimi, për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).

### 5.2 Përgjegjësia përpara Bursës ALSE për shlyerjen e transaksioneve

Për çdo transaksion të kryer në Bursën ALSE përgjegjës para bursës për shlyerjen e transaksionit do të jetë Anëtari i cili dështon të realizojë me sukses shlyerjen dhe/ose shlyerjen finale të detyrimeve që rrjedhin nga ky transaksion brenda afateve kohore të përcaktuara në rregulloret dhe udhëzimet e Bursës ALSE.

Pa cënuar përgjegjësinë e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, në rastin kur Anëtari është një Agjent Jo-Shlyerës (AJSH), Agjenti Shlyerës (ASH) që përfaqëson Anëtarin në mirëbesim bën përpjekjet më të mira për shlyerjen në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet e ekzekutuara në Bursën ALSE nga Anëtari Jo-Shlyerës (AJSH), bazuar në kontratën ligjore të nënshkruar mes palëve, e cila i është vënë paraprakisht në dispozicion Bursës ALSE.

### 5.3 Detyrimet e Anëtarëve për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në Bursën ALSE

Anëtari që kërkon të blejë tituj merr masa që gjithmonë të ketë pozicione të mjaftueshme në vlera monetare në llogaritë e tij pranë Agjentit Shlyerës ose në sistemin AIPS për të mbuluar të gjithë transaksionet e ekzekutuara prej tij në Bursën ALSE për llogari të vet, dhe/ose të klientëve të tij.

Anëtari që kërkon të shesë tituj merr masa që gjithmonë të ketë pozicione të mjaftueshme në tituj në llogaritë për të cilat ai po tregton në Bursën ALSE, pranë Agjentit Shlyerës (kujdestar) ose në sistemin AFISaR për të mbuluar të gjithë transaksionet e ekzekutuara prej tij në Bursën ALSE për llogari të vet, dhe/ose të klientëve të tij.

### 5.4 Koha e Shlyerjes së Transaksioneve

Çdo transaksion i kryer në Bursën ALSE do të shlyhet në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e saj, por jo më vonë se ora 16:00 e ditës së dytë të punës (T+2) pas ditës së tregtimit (T+0). Transaksioni që rezulton i pashlyer pas orës 16:00 të ditës T+2, konsiderohet transaksion i dështuar.

### 5.5 Koha e Shlyerjes Finale të Transaksioneve

Pas dështimit të transaksionit në AFISaR në ditën T+2, Bursa ALSE do të fillojë procedurat e Shlyerjes Finale deri në afatin maksimal i cili nuk mund të jetë më i gjatë se shtatë (7) ditë pune pas datës së tregtimit (T+0).

## 6. PROCEDURAT NË RAST TË DËSHTIMIT NË VLERA MONETARE (CASH)

### 6.1 Dështimi në Vlera Monetare nga Anëtarët që janë Agjentë Shlyerës (ASH)

#### a) Procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE

- (i) Bursa ALSE në orën 10:00 të ditës T+2, merr informacionin nga AFISaR për mungesën e vlerës monetare dhe Anëtarin që është ASH i cili është palë blerëse në transaksion.
- (ii) Bursa ALSE njofton menjëherë Anëtarin që është ASH dhe i kërkon zyrtarisht që të plotësojë pozicionin e munguar në vlera monetare (cash) në llogarinë e tij në sistemin AIPS brenda afateve kohore, por jo më vonë se deri në orën 15:00 të ditës T+2.
- (iii) Nëse Bursa ALSE në orën 16:00 të ditës T+2, merr konfirmimin nga AFISaR për dështimin e transaksionit, ajollokon aksesin në Sistemin ETS duke pamundësuar tregtimin për Anëtarin që është ASH deri në momentin e zgjidhjes së situatës.
- (iv) Jo më vonë se në orën 12:00 të ditës T+3, Bursa ALSE i jep me shkrim Anëtarit që është ASH udhëzimet për Shlyerjen Finale, siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).
- (v) Për mospërbushje të pozicionit nga Anëtari që është ASH deri në 16:00 të ditës T+7, si dhe për mospërbushje të gjitha pikave të mësipërme Bursa ALSE merr masat disiplinore në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi.

#### b) Detyrimet e Anëtarit që është Agjent Shlyerës (ASH)

- (i) Me të marrë njoftim nga Bursa ALSE, Anëtari që është ASH merr masa për plotësimin e pozicionit të munguar në vlera monetare (cash) në llogarinë e tij në sistemin AIPS brenda afateve kohore, por jo më vonë se ora 15:00 e ditës T+2.
- (ii) Pas plotësimit të pozicionit, Anëtari që është ASH njofton Bursën ALSE, duke dhënë edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me mungesën e pozicionit.
- (iii) Nëse Anëtari që është ASH, dështon në plotësimin e pozicionit në vlera monetare (cash), njofton Bursën ALSE duke dhënë edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me dështimin, si dhe duke sugjeruar rrugët e zgjidhjes.
- (iv) ASH zbaton udhëzimet me shkrim të Bursës ALSE në lidhje me procedurën e Shlyerjes Finale, siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).

### 6.2 Dështimi në Vlera Monetare nga Anëtarët që janë Agjentë Jo-Shlyerës (AJSH)

#### a) Procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE

- (i) Bursa ALSE në orën 15:00 të ditës T+0, merr informacionin nga Agjenti Shlyerës (ASH) për mungesën e vlerave monetare (cash) që pamundësojnë shlyerjen e transaksionit të ekzekutuar në Bursën ALSE nga ana e Anëtarit që është Agjent Jo-Shlyerës (AJSH), në llogaritë e AJSH të mbajtura nën kujdestarinë e Agjentit Shlyerës, dhe nëse ky i fundit e kërkon me shkrim, Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETS duke pamundësuar tregtimin për Anëtarin që është AJSH deri në momentin e zgjidhjes së situatës.
- (ii) Bursa ALSE njofton menjëherë Anëtarin që është AJSH dhe i kërkon zyrtarisht që të plotësojë pozicionin e munguar në vlera monetare (cash) në llogarinë e tij pranë Agjentit Shlyerës duke dhënë edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me mungesën e pozicionit.
- (iii) Pas njoftimit me shkrim të Agjentit Shlyerës në lidhje me shlyerjen e detyrimit nga Anëtari që është AJSH, Bursa ALSE mund të zhbllokojë aksesin e tij në Sistemin ETS.
- (iv) Nëse Anëtari që është AJSH nuk plotëson pozicionin e munguar deri në orën 16:00 të ditës T+2, Bursa ALSE edhe në rastet kurnuk ka ardhur kërkesë nga Agjenti Shlyerës, i

blokon aksesimin e sistemit ETS, AJSH-së duke pamundësuar tregtimin për Anëtarin AJSH deri në momentin e zgjidhjes së situatës.

- (v) Për mospërbushje të pozicionit të munguar nga Anëtari që është AJSH, si dhe për mospërbushje të gjitha pikave të mësipërme Bursa ALSE merr masat disiplinore në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi.
- (vi) Bursa ALSE merr informacion nga ASH pas mbylljes së procesit bazuar në marrëveshjen e nënshkruar mes palëve në mënyrë që të mundesoj hapjen e sistemit për Anëtarin AJSH.

**b) Detyrimet e Anëtarit që është Agjent Jo-Shlyerës (AJSH)**

- (i) Me të marrë njoftim nga Bursa ALSE dhe/ose nga Agjenti Shlyerës i tij, Anëtari që është AJSH merr masa për plotësimin e pozicionit të munguar në vlera monetare (cash) në llogarinë e tij pranë Agjentit Shlyerës.
- (ii) Pas plotësimit të pozicionit, Anëtari që është AJSH njofton Bursën ALSE dhe/ose Agjentin Shlyerës të tij, duke dhënë me shkrim edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me mungesën e pozicionit.
- (iii) Nëse Anëtari që është AJSH, dështon në plotësimin e pozicionit në vlera monetare (cash), njofton Bursën ALSE dhe/ose Agjentin Shlyerës të tij duke dhënë me shkrim edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me dështimin.

**c) Detyrimet e Agjentit Shlyerës (ASH)**

- (i) Agjenti Shlyerës që vepron si kujdestar për Anëtarin e ALSE i cili është AJSH njofton Bursën ALSE jo më vonë se ora 15:00 të ditës T+0 në lidhje me mungesën e pozicionit në vlera monetare (cash) të Anëtarit që është AJSH dhe kur e shikon të arsyeshme kërkon me shkrim pezullimin e aksesit të AJSH në sistemin ETS,
- (ii) ASH njofton me shkrim Bursën ALSE, menjëherë pasi Anëtari që është AJSH ka shlyer detyrimin që vinte nga mungesa e pozicionit në vlera monetare (cash). Pas marrjes së këtij njoftimi me shkrim nga Agjenti Shlyerës, Bursa ALSE mund të heqë pezullimin e aksesit në Sistemin ETS për Anëtarin që është AJSH.

## **7. PROCEDURAT NË RAST TË DËSHTIMIT NË TITUJ**

### **7.1 Dështimi në Tituj nga Anëtarët që janë Agjentë Shlyerës (ASH)**

**a) Procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE**

- (i) Bursa ALSE në orën 10:00 të ditës T+2, merr informacionin nga AFISaR për mungesën e titujve dhe Anëtarin që është ASH që është palë shitëse në transaksion.
  - (ii) Bursa ALSE i kërkon menjëherë Anëtarit që është ASH që të plotësojë pozicionin e munguar në tituj në llogarinë e tij në sistemin AFISaR brenda afateve kohore, por jo më vonë se ora 15:00 të ditës T+2.
  - (iii) Në rast mosplotësimi të pozicionit nga ASH deri në orën 15:00 të ditës T+2, Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETS duke pamundësuar tregtimin për Anëtarin deri në momentin e zgjidhjes së situatës.
  - (iv) Jo më vonë se në orën 12:00 të ditës T+3, Bursa ALSE i jep me shkrim Anëtarit që është ASH udhëzimet për Shlyerjen Finale, siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).
- (v) Për mospërbushje të pozicionit të munguar nga Anëtari që është ASH deri në 16:00 të ditës T+7, si dhe për mospërbushje të gjitha pikave të mësipërme Bursa ALSE merr masat disiplinore në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi.

**b) Detyrimet e Anëtarit që është Agjent Shlyerës (ASH)**

- (i) Me të marrë njoftim nga Bursa ALSE, Anëtari që është ASH merr masa për plotësimin e pozicionit të munguar në tituj në llogarinë e tij në sistemin AFISaR brenda afateve kohore, por jo më vonë se ora 15:00 të ditës T+2.
- (ii) Pas plotësimit të pozicionit, Anëtari që është ASH njofton Bursën ALSE, duke dhënë me shkrim edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me mungesën e pozicionit.
- (iii) Nëse Anëtari që është ASH, dështon në plotësimin e pozicionit në tituj, njofton Bursën ALSE duke dhënë edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me dështimin, si dhe duke sugjeruar rrugët e zgjidhjes.
- (iv) Zbaton udhëzimet me shkrim të Bursës ALSE në lidhje me procedurën e Shlyerjes Finale, siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).

**7.2 Dështimi në Tituj nga Anëtarët që janë Agjentë Jo-Shlyerës**

**a) Procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE**

- (i) Bursa ALSE në orën 15:00 të ditës T+0, merr informacionin me shkrim nga Agjenti Shlyerës (ASH) për mungesën e titujve që pamundësojnë shlyerjen e transaksionit të ekzekutuar në Bursën ALSE nga ana e Anëtarit që është Agjent Jo-Shlyerës (AJSH), në llogaritë e AJSH të mbajtura nën kujdestarinë e Agjentit Shlyerës.
- (ii) Bursa ALSE komunikon me AJSH duke kërkuar me shkrim në mënyrë të argumentuar mungesën e Titujve në transaksionin.
- (iii) Bursa ALSE kërkon nga ASH bllokimin e garancisë deri në zgjidhjen e situatës.
- (iv) Bursa ALSE komunikon me palën pjesëmarrëse në transaksion ku në mënyrë të argumentuar i komunikon me shkrim fshirjen e transaksionit dhe procedurën e ndjekur në rastet e transaksionit të dështuar siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).
- (v) Për mospërbushje të detyrimeve nga Anëtari që është AJSH kundrejt palës së dëmtuar deri në orën 16:00 të ditës T+7, si dhe për mospërbushje të gjitha pikave të mësipërme Bursa ALSE merr masat disiplinore në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi.

**b) Detyrimet e Anëtarit që është Agjent Jo-Shlyerës (AJSH)**

- (i) Me të marrë njoftim nga Bursa ALSE, Anëtari që është AJSH merr masa për plotësimin e detyrimeve që lindin ndaj palës në transaksion siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).
- (ii) Pas plotësimit të detyrimit, Anëtari që është AJSH njofton Bursën ALSE dhe Agjentin Shlyerës të tij, duke dhënë edhe shpjegimin e argumentuar me shkrim në lidhje me mungesën e pozicionit.
- (iii) Nëse Anëtari që është AJSH, dështon në plotësimin detyrimit siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default), njofton Bursën ALSE dhe/ose Agjentin Shlyerës të tij duke dhënë me shkrim edhe shpjegimin e argumentuar në lidhje me dështimin.

**c) Detyrimet e Agjentit Shlyerës (ASH)**

- (i) Njofton Bursën ALSE jo më vonë se ora 15.00 të ditës T+0 në lidhje me mungesën e pozicionit në tituj të Anëtarit që është AJSH, për të cilin ky Agjent Shlyerës vepron dhe kërkon fshirjen e transaksionit.

- (ii) Në rast të dështimit të transkasionit në tituj, zbaton udhëzimet me shkrim të Bursës ALSE në lidhje me procedurën e bllokimit të garancisë, siç përcaktohet në Seksionin 8 të këtij udhëzimi për Procedurat e Pas-Dështimit (Post-Default).

## **8. PROCEDURAT E NDJEKURA NË PERIU DHËN E PAS-DËSHTIMIT (POST-DEFAULT)**

### **8.1 Procedurat e Pas-Dështimit në Vlera Monetare (cash)**

Përfshin procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE dhe pjesëmarrësit e tregut pas dështimit të transaksionit të ekzekutuar në bursë në përmbushjen e detyrimeve në vlera monetare (cash).

1. Jo më vonë se ora 12:00 e ditës T+3, Bursa ALSE dërgon me shkrim udhëzimet për pjesëmarrësit e tregut që janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në dështimin e transaksionit në vlera monetare (cash).
2. Këto udhëzime përfshijnë, por nuk kufizohen me veprimet si vijon:

#### **a) Procedurat e Pas-Dështimit në Vlera Monetare (cash) për Agjentin Shlyerës**

- (i) Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETStë palës dështuese;
- (ii) Bursa ALSE informon palët që kanë kohe deri në orën 16:00 të ditës T+7 për shlyerjen përfundimtare të transaksionit në OTC.
- (iii) Palët kanë si detyrim të informojnë ALSE hap pas hapi deri në momentin e shlyerjes përfundimtare në OTC.
- (iv) Në rast se palët bien dakord për anulimin e transaksionit të dështuar paraditës T+7, i kërkohet me shkrim Bursës ALSE miratimin e anulimit.
- (v) Bursa ALSE vlerëson kërkesën për anulimin e transaksionit të dështuar dhe nëse e shikon të arsyeshme e miraton atë.
- (vi) Bursa ALSE merr masa administrative për Anëtarin që është edhe ASH në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi, për cënim të integritetit të tregut të Bursës ALSE.
- (vii) Bursa ALSE njofton me shkrim palën dështuese për detyrimin e pagesës në favor të palës së dëmtuar në transaksion në vlerën e 5 % të volumit të transaksionit përkatës të dështuar, por jo më shumë se 500.000 LEK;

#### **b) Procedurat e Pas-Dështimit në Vlera Monetare (cash) për Agjentin Jo-Shlyerës**

- (i) Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETStë Anëtarit që është AJSH;
  - (ii) Bursa ALSE merr masa administrative për Anëtarin që është AJSH në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi, për cënim të integritetit të tregut të Bursës ALSE.
  - (iii) Bursa ALSE pret informacion nga ASH i cili vepron si kujdestar i Anëtarit AJSH pas mbylljes së procesit bazuar në marrëveshjen e nënshkruar mes palëve në mënyrë që të mundesojë hapjen e sistemit për AJSH.
3. Procedurat dhe veprimet e parashikuara në këtë nen duhet të mbyllën jo më vonë se ora 16.00 e ditës T+7. Pas këtij afati kohor, palët mund t'i drejtohen Komitetit të Arbitrazhit në ALSE, ose organeve të tjera kompetente (kur është e aplikueshme).

### **8.2 Procedurat e Pas-Dështimit në Tituj**

Përfshin procedurat e ndjekura nga Bursa ALSE dhe pjesëmarrësit e tregut pas dështimit të transaksionit të ekzekutuar në bursë në përmbushjen e detyrimeve në titujt.

1. Jo më vonë se ora 12.00 e ditës T+3, Bursa ALSE dërgon me shkrim udhëzimet për pjesëmarrësit e tregut që janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazinë dështimin e transaksionit në tituj.
2. Këto udhëzime përfshijnë, por nuk kufizohen meveprimet si vijon:

**a) Procedurat e Pas-Dështimit në Tituj për Agjentin Shlyerës**

- (i) Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETStë palës dështuese;
- (ii) Bursa ALSE informon palët që kanë kohë deri në orën 16:00 të ditës T+7 për shlyerjen përfundimtare të transaksionit në OTC.
- (iii) Palët kanë si detyrim të informojnë Bursën ALSE hap pas hapi deri në momentin e shlyerjes përfundimtare në OTC.
- (iv) Në rast se palët bien dakordanullimin e transaksionit të dështuar paradiës T+7, i kërkojnë me shkrim Bursës ALSE miratimin e anulimit.
- (v) Bursa ALSE vlerëson kërkesën për anulimin e transaksionit të dështuar dhe nëse e shikon të arsyeshme e miraton atë.
- (vi) Bursa ALSE merr masa administrative për Anëtarin që është edhe ASH në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi, për cënim të integritetit të tregut të Bursës ALSE.
- (vii) Bursa ALSE njofton me shkrim palën dështuese për detyrimin e pagesës në favor të palës së dëmtuar në transaksion në vlerën e 5 % të volumit të transaksionit përkatës të dështuar por jo më shumë se 500.000 LEK.

**b) Procedurat e Pas-Dështimit në Tituj për Agjentin Jo-Shlyerës**

- (i) Bursa ALSE bllokoi aksesin në Sistemin ETStë palës dështuese,
  - (ii) Bursa ALSE njofton me shkrim Anëtarin që është AJSH për detyrimin e pagesës për palën e dëmtuar në transaksion në vlerën e 5 % të volumit të transaksionit përkatës të dështuar por jo më shumë se 500.000 LEK deri deri në orën 16:00 të ditës T+7,
  - (iii) Bursa ALSE pret informacion nga të dy palët (pala dështuese dhe pala e dëmtuar në transaksion) për shlyerjen e detyrimit të përcaktuar në pikën e mësipërme, vetëm pas këtij njoftimi Bursa ALSE njofton ASH që vepron si kujdestar i AJSH-së të zhblokojë garancinë.
  - (iv) Bursa ALSE merr masa administrative për Anëtarin që është AJSH në përputhje me kuadrin rregullativ të ALSE në fuqi, për cënim të integritetit të tregut të Bursës ALSE;
3. Procedurat dhe veprimet e parashikuara në këtë nen duhet të mbyllen jo më vonë se ora 16.00 e ditës T+7. Pas këtij afati kohor, palët mund t'i drejtohen Komitetit të Arbitrazhit në ALSE, ose organeve të tjera kompetente (kur është e aplikueshme).

**KRYETARI**  
**Hysen ÇELA**